

OUCH!

NË KËTË EDICION..

- Hyrje
- Rreziqet
- Edukimi i fëmijëve

Edukimi i fëmijëve mbi sigurinë kibernetike

Hyrje

Ka shumë mënyra sot se si fëmijët tanë mund të kenë qasje online dhe të bashkëpunojnë në Internet. Shërbimet e reja mediale dhe sociale po dalin si kërpudhat pas shiut dhe çdoherë e më shumë ka numër të madh aplikacionesh dhe lojërash që lidhin njerëzit online. Poashtu ka plot shkolla që po kalojnë në shërbimet si Google Drive dhe kërkojnë që disa punime apo të gjitha detyrat të bëhen dhe të dorëzohen online. Me plot kuptimin e fjalës fëmijët tanë po rriten të "lidhur në rrjet". Edhe pse kjo ka shumë përparësi, këto mundësi vijnë edhe me rreziqe. Në këtë broshurë ne do të flasim për tre lloje rreziqesh për fëmijët tuaj dhe ç'mund të bëni ju që t'i mbani të sigurt.

Botuesi i ftuar

Bob Rudis është një studiues i sigurisë së të dhënave në Verizon, autor i raportit të vitit 2015 mbi hetimet e abuzimeve me të dhëna (2015 Data Breach Investigations Report) dhe kujdestar i katër fëmijëve të shkëlqyeshëm. Bobi ka themeluar dhe ka udhëhequr programe efektive mbi sigurinë në shumë kompani të suksesshme (Fortune 100). Ju mund ta ndiqni Bobin në Twitter [@hrbrmstr](https://twitter.com/hrbrmstr).

Rreziqet

1. **Sjellja:** Kur bashkëpunojnë në komunitete online apo botë virtuale, fëmijë sillen ndryshe nga si do të silleshin në jetë. Mungesa e prezencës fizike mund t'ju japë një ndjenjë të fuqishme të të qenit anonim, sidomos te fëmijët. Si rezultat i kësaj shpesh ju vjen një guxim që të shprehen në mënyra që mund t'i lëndojë fëmijet tjerë, veprim që njihet me termin shantazh online (ang. Cyberbullying). Gjithashtu fëmijë mund të bëhen viktimë e tjerëve që edhe mund të jenë me qëllime të këqija apo t'i lëndojnë ata.
2. **Kontakti:** Në kohën që jetojmë fëmijët janë gati gjithë kohës në komunikim me të tjerë, duke dërguar mesazhe, duke folur në komunitete online ose duke luajtur lojëra në botën virtuale. Mungesa e kontaktit fizik shpesh shkakton një ndjesi harrese të ta që individi në anën tjetër të komunikimit të mos jetë ai/ajo që thotë se është dhe mund të mos kenë qëllime të mira. Sulmuesit janë vazhdimisht në këto rrugë digjitale dhe do të përdorin çdo mënyrë për të krijuar raporte të afërta me viktimat e tyre, shpesh duke pretenduar që janë vetë fëmijë.
3. **Përmbajtja:** Nuk janë të pakta edhe mënyrat se si të bëhen xhirime, incizohet një zë, bëhet një fotografi apo shkruhet një mesazh. Fëmijët kanë tendencë të bëjnë postime të tepërta dhe të ndajnë shumë gjëra personale për veten apo familjen e tyre pa qenë të vetëdijshëm për pasojat që mund të sjellë kjo. Fëmijët poashtu nuk janë të njoftuar me rrezikun e vjedhjes së identitetit apo për infektimet me programe të rrezikshme apo viruse që i mashtrojnë ata të përgjigjen në sfida apo pyetje të ndryshme apo t'i detyrojnë ata të hapin ndonjë faqe interneti

Edukimi i fëmijëve mbi sigurinë kibernetike

ose klikojnë në një link. Në fund, ne jetojmë në një kohë kur nuk ka buton 'zhbëje' kur gjërat postohen online apo ndahen me të tjerë. Fëmijët mendojnë që shërbimet si Kik, Instagram, Snapchat dhe postimet tjera janë momentale, por ato postime mund të kthehen në një makth për ta dhe familjarët e tyre në një moment të mëvonshëm në jetë.

Edukimi i fëmijëve

Gjëja e parë që ju mund të bëni për t'i mbrojtur fëmijët tuaj është të flisni hapur me ta. Informohuni se me çfarë aktivitete merren fëmijët tuaj online, mësoni ata për rreziqet në ditët e sotme, dhe çfarë mund të bëjnë ata që të vetëmbrohen.

- Siguria në shtëpi:** Edhe pse ka rreziqe, shtëpa është vendi ku fillojnë sjelljet e sigurta online. Sa më herët në moshë që filloni të flisni me fëmijët tuaj, edhe ata me ju, aq më mirë. Bëni diskutime të rregullta mbi sigurinë online, dhe pse jo shkoni edhe më tej duke i ilustruar atyre gjërat negative që kanë ndodhur online. Nëse nuk e dini saktë se me çfarë aktivitete merren fëmijët tuaj online, thjesht pyesni. Bëni sikur jeni prind i paditur dhe kërkonte fëmijës suaj t'ju tregojë për teknologjitë e reja dhe si ai i përdor ato. Fëmijëve ju pëlqen shumë ideja të bëjnë si mësues dhe do të hapen me ju. Për shembull, ndoshta ata janë duke përdorur Instagramin, kërkojini t'ju mësojnë si ta përdorin atë, dhe kërkoji që ta krijojnë një llogari edhe juve dhe t'i ndiqni pastaj. Kështu jo vetëm mësoni dhe njëkohësisht monitoroni se çfarë bëjnë fëmijët tuaj online, por e bëni edhe më të lehtë për ta të flasin me ju. Poashtu mundohuni, aq sa është e mundur, që t'i kërkonte fëmijëve të kryejnë aktivitetet e tyre online në një vend të përbashkët dhe me kohë të kufizuar. Duke pasur një kompjuter në një vend të përbashkët, fëmijët ka gjasa më të vogla të përfshihen në sjellje të rrezikshme. Është e rekomandueshme edhe të bëni një rregull që të keni një vend të përbashkët ku i rimbushni bateritë e telefonave, ashtu që fëmijët t'i lejnë telefonat aty para se të shkojnë të flenë.
- Siguria me të tjerë:** Kur fëmijët janë larg shtëpisë, janë më të rrezikuar. Ndhimojini fëmijëve tuaj ta kuptojnë që rregullat për siguri online vlejné kudo që ata shkojnë, dhe rregullat që keni në shtëpi t'ia transmetojnë kujtdo që kujdeset për ta. Nëse kanë pajisje mobile me vete, kontrolloni mënyrën e përdorimit (kohën dhe trafikun) të shihni nëse ka shenja që ata po abuzojnë me faktin që janë larg shtëpisë. Ju nuk do të mund t'i ndaloni të gjitha rreziqet, por fjalët tuaja qëllimmira do t'ju shkojnë në mend fëmijëve tuaj në kohën e duhur.
- Siguria në numra:** Ju nuk jeni vetëm në këtë kujdes online, dhe ju duhet t'i përfshini edhe të tjerët, si p.sh. prindërit tjerë, kujdestarët, vëllezërit e motrat, mësuesit, dhe shoqërinë në mënyrë që të shtoni kujdesin ndaj



Çelësi për t'i mbrojtur fëmijët tuaj online është t'i edukoni ata mbi rreziqet që mund të ballafaqohen dhe të siguroheni që ata jo vetëm ju i flisni atyre por edhe ata mund të flasin me ju për këto çështje.

Edukimi i fëmijëve mbi sigurinë kibernetike

ndonjë sjelljeje të dëmshme online. Mundohuni të influenconi komunitetin ku jetoni në mënyrqë edhe ata të kujdesen për fëmijet e tyre dhe të kenë komunikime të hapura dhe pozitive me ta kur i shohin fëmijet duke shkuar drejt rrugës së gabuar.

Në fund, kur fëmijët bëjnë gabime, trajtoni secilin gabim të tyrin si një rast për mësim dhe jo të ndërmerrni menjëherë masa ndëshkuese. Spjegoni arsyet gjithmonë dhe rikujtoni atyre që ju vetëm po provoni t'i mbronin ata nga rreziqet që ata nuk mund t'i shohin në moshën e tyre. Tregoni fëmijëve tuaj që ata mund të vijnë çdoherë te ju kur dhe nëse ata ballafaqohen me komunikime shqetësuese online, madje edhe t'ju tregojnë rastin drejtpërdrejt. Sigurohuni që ata të kenë guximin të vijnë te ju edhe kur e kanë kuptuar që kanë bërë diçka jo të mirë. Të mbani komunikimin e hapur dhe të vazhdueshëm është mënyra më e mirë që t'i ndihmoni fëmijët tuaj të jenë të sigurt në botën digjitale në të cilën jetojmë.

Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyesë profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

Burimet

Cyber Smart: <http://www.cybersmart.gov.au/Parents.aspx>
OnGuard Online: <http://www.onguardonline.gov/topics/protect-kids-online>
Stay Safe Online: <https://www.staysafeonline.org/stay-safe-online/for-parents/raising-digital-citizens>
Securing Kids Panel: <http://www.rsaconference.com/media/into-the-woods-protecting-our-youth-from-the-wolves-of-cyberspace>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në ouch@securingthehuman.org.

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



securingthehuman.org/blog



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpls](https://www.securingthehuman.org/gpls)